

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 358/2022

Datë: 30/12/2022

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019) dhe nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores QRK - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren QRK-Nr. 04/2021 dhe Rregulloren QRK-Nr. 03/2022, Ministria e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë 2023 – 2025.
2. Obligohen Agjencitë Ekzekutive, Departamentet, Divizionet dhe njësitë tjera të Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e Planit nga pika një (1) e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Albulena HAXHIU
Ministre e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Agjencive Ekzekutive; Departamenteve; Divizioneve dhe Njësive të MD-së;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK 2023-2025

Dhjetor 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Përmbledhje ekzekutive	5
Fjala e Ministres Albulena Haxhiu.....	7
1. Hyrje.....	9
2. Metodologjia	11
3. Sfondi	12
4. Objektivat	17
4.1. Objektivi 1 - Ministria e përgatitur me staf profesional.....	19
4.2. Objektivi 2 - Digjitalizimi i MD-së	19
4.3. Objektivi 3 - Agjenci ekzekutive efikase në kuadër të MD-së.....	19
4.4. Objektivi 4 - Ministria më afër publikut.....	19
5. Ndikimi Buxhetor.....	20
6. Veprimet specifike.....	24

Lista e shkurtesave

- AAPSK – Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AD – Akademia e Drejtësisë së Kosovës
AKK – Agjencia Kundër Korrupsionit
ANJF – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
BE – Bashkimi Evropian
CEPEJ – Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
DBF – Divizioni për Buxhet dhe Financa
DBJN – Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DBNJ – Divizioni i Burimeve Njerëzore
DDHS – Divizioni për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara
DFSHP – Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
DIEKP – Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DIT – Divizioni për IT
DL – Departamenti Ligjor
DP – Divizioni i Prokurimit
DPL – Departamenti për Profesionet e Lira
IML – Instituti i Mjekësisë Ligjore
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KN – Koordinatorin Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD – Ministria e Drejtësisë
MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
PKZMSA – Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
PZHS – Plani Zhvillimor Strategjik

RFSSL - Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit

SEQP - Sistemi i Evidencës Qendrore Penale

SMDHFDHG - Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026

SMIL - Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

SSL - Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2025

SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK - Shërbimi Sprovues i Kosovës

ZAK - Zgjidhja alternative e kontesteve

Përmbledhje ekzekutive

Sistemi i drejtësisë është një nga shtyllat kyçe të funksionimit të Republikës së Kosovës që ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të saj. Ministria e Drejtësisë si institucion ekzekutiv i Qeverisë zhvillon politikat dhe ligjet në këtë fushë në bashkëpunim me institucionet tjera të pavarura si gjyqësori dhe prokuroria, të cilat pastaj zbatohen nga ato. Përveç kësaj Ministria ka edhe kompetenca ekzekutive në fushat si sanksionet penale, ndihma juridike ndërkombëtare, ndihma juridike falas, administrimi i pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, mjekësia ligjore, profesionet e lira, mbështetja e viktimave të krimit, përfaqësimi i institucioneve publike në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit dhe kompetenca ekzekutive në fusha të tjera.

Ky sistem është konsoliduar deri tash me zhvillimin e një game të gjerë të politikave dhe ligjeve, mirëpo të njëjtat sipas raporteve ndërkombëtare por edhe vendore ende janë duke u zbatuar pjesërisht si dhe përcjellën me pengesa e vështirësi, duke cenuar kështu efikasitetin e sistemit të drejtësisë.

Për tu ngritur ky efikasitet, Ministria e Drejtësisë siç u cek më lartë ka rol shumë të rëndësishëm, madje në disa aspekte edhe vendimtar. Andaj ky dokument identifikon nevojën për ngritjen e kapaciteteve profesionale të Ministrisë, digjitalizimin e saj, ngritjen e efikasitetit të agjencive të saj ekzekutive si SHKK, SHSK, Inspektorati i Ministrisë, AAPSK, IML, Avokatura Shtetërore dhe ANJF, dhe zhvillimit edhe më transparent të punës duke i ofruar publikut qasje në kohë në informatat, dokumentet dhe shërbimet që zhvillohen ose ofrohen nga MD. Këto katër çështje pra janë objektivat e përcaktuara me këtë Plan Zhvillimor Strategjik i cili është hartuar për tre vite (2023-2025) dhe në kuptim të adresimit të problemeve dhe sfidave konkrete të identifikuara, ka paraparë veprime specifike për t'i adresuar ato dhe si rrjedhojë fuqizuar rolin e lartpërmendur të Ministrisë.

Ky Plan është hartuar në disa faza, që ka përfshirë identifikimin e problemeve dhe sfidave qoftë nga ekspertiza e jashtme e ofruar për Ministrinë përmes raporteve dhe analizave të ndryshme, por edhe burimet e brendshme përmes takimeve dhe konsultimeve, dhe pastaj hartimin dhe konsultimin publik të Planit që ka siguruar ngritjen e mëtutjeshme të cilësisë. Plani përfshin edhe ndikimin buxhetor të tij, si dhe ka përcaktuar edhe metodologjinë e monitorimit dhe raportimit për të siguruar që veprimet e planifikuara zbatohen në praktikë.

Sa i përket veprimeve të planifikuara ato janë të llojeve të ndryshme, duke filluar nga ristrukturimi i Ministrisë, trajnimeve të veçanta për stafin, plotësimin e pozitave vakante, krijimin e bazave të reja të të dhënave apo aplikacioneve, ndërlidhja e tyre, qasja e Ministrisë në SMIL dhe SEQP, ofrimi i shërbimeve online, hartimi apo rishikimi i dokumenteve të veçanta strategjike për agjencitë ekzekutive në kuadër të Ministrisë,

ridizajnimi i webfaqeve, organizimi i fushatave vetëdijesuese dhe veprime tjera specifike.

Veprimet e planifikuara kontribuojnë drejtpërdrejtë edhe në zbatimin nga Ministria të Planit të Punës së Qeverisë, por edhe strategjive dhe planeve tjera specifike të nivelit qeveritar apo ndër-institucional të zhvilluara dhe aktualisht duke u zbatuar në bashkëpunim me institucionet e pavarura.

Fjala e Ministres Albulena Haxhiu

Të nderuar bashkëpunëtorë në Ministrinë e Drejtësisë, institucione tjera të sistemit të drejtësisë, partnerë zhvillimorë dhe qytetarë, gra e burra, të Republikës së Kosovës,

‘Kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë’ – kjo është thënia e cila ka motivuar punën tonë të përditshme në Ministrinë e Drejtësisë që nga ditët e para të besimit të mandatit dhe përpjekjeve tona të përbashkëta për të arritur këtë synim. Me ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm, kemi arritur gjatë viteve 2021 dhe 2022, të zhvillojmë politika dhe ligje të rëndësishme për sistemin, ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës, por edhe marrim vendime të rëndësishme të madhe. Këto vendime kanë ndikuar drejtpërdrejtë në eliminimin e dukurive negative, si jo-profesionalizmi, nepotizmi dhe korrupsioni, që deri para disa viteve janë konsideruar si ‘normale’ në sistemin tonë, ndërsa sot janë në rënie e sipër.

Pavarësisht rezultateve të arritura deri tash, jemi të vetëdijshëm se para vetes kemi ende shumë punë për të bërë për të konsoliduar një shtet ligjor në zbatim të vlerave kushtetuese. Duke parë rolin vital të Ministrisë së Drejtësisë në reformën e nisur, është thelbësore që në të, të shërbejnë profesionistë të vërtetë të cilët e rrisin efikasitetin e vetë Ministrisë, agjencive ekzekutive të saj dhe si rrjedhojë ofrojnë transparencë dhe qasje të plotë në punët dhe shërbimet e Ministrisë, por edhe me punën e tyre ndikojnë në rritjen e profesionalizimit dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë.

Kjo do të rezultonte pastaj në hetim të pavarur të veprave penale në Kosovë, zgjidhje më të shpejtë të kontesteve të ndryshme gjyqësore, ofrim të një mjedisi të përshtatshëm për zhvillim ekonomik, mbrojtje të viktimave, barazi gjinore dhe mbrojtje dhe sigurim më të madh të të drejtave të njeriut në përgjithësi në Kosovë.

Një Ministri e suksesshme krijon një sistem të suksesshëm të drejtësisë. Andaj ky Plan Zhvillimor Strategjik i brendshëm i Ministrisë, i hartuar për tre vitet e ardhshme, me identifikim të saktë të sfidave dhe problemeve të brendshme, objektiva dhe veprime specifike të qarta, do të hapë rrugën e së ardhmes drejt këtij suksesi.

Plani do të na ndihmojë gjithashtu që të krijojmë dhe zhvillojmë profesionistë, procese të punës, shërbime dhe komunikim të përshtatshëm dhe nevojshëm për të avancuar Republikën e Kosovës drejt anëtarësisë në Bashkimin Evropian, dhe bashkëpunuar suksesshëm në forma të ndryshme me të gjitha shtetet tjera të rajonit, Evropës, SHBA-në dhe më gjerë.

Për të gjitha këto na duhet përkushtimi dhe bashkëpunimi i të gjithë juve, duke filluar nga stafi aktual i Ministrisë, partnerëve zhvillimor të cilët i falënderojmë për mbështetjen në përgatitjen e këtij Plani dhe mbështetjen e sektorit të drejtësisë në përgjithësi, por edhe

institucioneve të pavarura. Gjithashtu, jemi falënderues edhe ndaj vet juve si qytetarë të Kosovës që përmes adresimeve dhe takimeve të shumta na keni ndihmuar të kuptojmë vështirësitë e sistemit të drejtësisë së Kosovës.

Uroj që pas tre viteve të gjithë të jemi krenarë me këtë Plan të zbatuar, me shumë veprime, vendime dhe shembuj të sukseseve tona të arritura.

Sinqerisht,

Albulena Haxhiu
Ministre e Drejtësisë

1. Hyrje

Në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e drejtësisë si dhe zbatimin e tyre në fusha të caktuara. Kompetencat e Ministrisë janë të përcaktuara përmes ligjeve relevante si dhe në mënyrë të veçantë me Rregulloren e Qeverisë¹ si dhe Rregulloren e brendshme të MD-së.² Si pjesë e MD-së aktualisht funksionojnë gjashtë (6) departamente me trembëdhjetë (13) divizione, si dhe tre (3) divizione me raportim të drejtpërdrejtë tek Sekretari i Përgjithshëm i MD-së dhe dy (2) divizione me raportim të drejtpërdrejtë tek Ministria. Gjithashtu, gjashtë (6) agjenci ekzekutive: SHKK, SHSK, Inspektorati i Ministrisë, AAPSK, IML dhe Avokatura Shtetërore, janë pjesë e MD-së. Nga Shtatori i këtij viti, në kuadër të procesit të racionalizimit të agjencive të pavarura, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka kaluar gjithashtu në kuadër të MD-së si agjenci ekzekutive.



Figura 1 - Kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë

Fushat e zbatimit në kompetencë të Ministrisë aktualisht pra janë: sanksionet penale, ndihma juridike ndërkombëtare, ndihma juridike falas, administrimi i pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, mjekësia ligjore, profesionet e lira (noteria, përmbarimi privat, ndërmjetësimi, administrimi i falimentimit), mbështetja e viktimave të krimit duke përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, përfaqësimi i institucioneve publike në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit, dhe koordinimi i procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, por edhe fusha tjera të ndërlidhura. Gjithashtu, nga viti 2023 në Ministrinë e Drejtësisë planifikohet të barten disa kompetenca lidhur me çështjet e shërbimeve sociale dhe rrjedhimisht do të planifikohen aktivitetet me interes të zhvillimit të shërbimeve sociale.

¹ Rregullore (QRK) - nr. 02/2021 për Fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. 30.03.2021. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317>

² Rregullorja QRK-nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë. 27.12.2013. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8971> Kjo Rregullore është ndryshuar dhe plotësuar nga Rregullorja QRK-nr.12/2018. 31.07.2018. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/C9444161-1189-4794-AEEA-A69FD0181A19.pdf>

Deri në vitin 2022 janë miratuar një numër i konsiderueshëm i ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e drejtësisë, por edhe dokumente tjera udhëzuese, me qëllimin e konsolidimit të kornizës ligjore dhe efikasitetin e zbatimit të tyre nga institucionet e ndryshme të drejtësisë. Pavarësisht kësaj, një sërë problemesh dhe sfidash vazhdojnë të ekzistojnë. Planifikimi i Ministrisë për të adresuar ato, paraqitet në dokumente të ndryshme strategjike të nivelit qeveritar dhe më gjerë.

Së pari, Programi i Qeverisë³ ka prioritetizuar fushën e drejtësisë duke përcaktuar qartë vizionin e Qeverisë për drejtësi të pavarur, të paanshme, efikase dhe profesionale, si dhe misionin për fuqizimin e këtij sistemi dhe rritjen e besimit qytetar. Si rrjedhojë e këtij Programi është miratuar Plani Strategjik Operacional 2022-2025⁴, që përcakton qëllimet dhe nën-qëllimet strategjike të konkretizuara pastaj me objektiva operacional gjegjësisht aktivitetet.

Natyrisht që një ndër synimet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës është anëtarësimi në BE. Në këtë drejtim, Ministria, në zbatim të MSA-së në mes Kosovës dhe BE-së, ka rol kyç në harmonizimin e politikave dhe legjislacionit të lartpërmendur vendor me *acquis* të BE-së, por edhe në avancimin sa i përket zbatimit efikas të tyre si kusht për këtë anëtarësim. Në kuadër të ERA II⁵ dhe PKZMSA-së 2022-2026⁶, kryesisht kapitujve 23 (gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe 24 (Drejtësia, liria dhe siguria), parashihen aktivitete specifike në drejtim të zbatimit të plotë të MSA-së.

Vizioni dhe misioni i lartpërmendur i Qeverisë është reflektuar edhe në Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026⁷ dhe Planin e Veprimit të saj 2021-2023⁸. Kjo Strategji e përbashkët me institucionet kryesore të sundimit të ligjit si KGJK, KPK, AD, MPB, Policia e Kosovës, AKK, OAK, ANJF, odat e profesioneve të lira dhe të tjera, përmban reformat kryesore që parashihen të ndërmerren në këtë sektor. Strategjia ka katër objektiva në të cilat MD ka rol kyç në zbatimin e reformave. Si pjesë e këtyre objektivave, janë një numër politikash dhe ligjesh që janë zhvilluar deri tash ose parashihen të zhvillohen, ndërsa disa prej nën-objektivave janë ekskluzive për MD-në, ku vlen të përmenden nën-objektivat e përmirësimit të ekzekutimit të sanksioneve penale; përmirësimit të ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira; dhe fuqizimit të rolit të Ministrisë së Drejtësisë.

³ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. Maj 2021. I qasshëm në: <https://krveministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

⁴ Plani Strategjik dhe Operacional 2022 – 2025. Pjesa e Ministrisë së Drejtësisë - Faqe 21 deri 23. I qasshëm në: <https://krveministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/RKS-PSO-2022-2025..pdf>

⁵ Agjenda për Reforma Evropiane. E qasshme në: <http://mei-ks.net/sq/plani-veprimit-zbatimin>

⁶ Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026. Prill 2022. I qasshëm në: http://mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026_shq.pdf

⁷ Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>

⁸ Plani i Veprimit (2021-2023) i Strategjisë për Sundimin e Ligjit. I qasshëm në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/99408591-0912-4383-A109-1F0AAFCS17BB.xlsx>

Një Strategji tjetër ndërinstitucionale, me MD-në në rol udhëheqës është Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2025⁹. Kjo Strategji parasheh rol proaktiv, por edhe koordinues dhe monitorues për MD-në sa i përket parandalimit dhe identifikimit të dhunës, avancimit dhe harmonizimit të politikave publike në këtë fushë, pastaj fuqizimit institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave, por edhe sigurimit të shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

PZHS si dokument i brendshëm i Ministrisë me qëllim të përmbushjes së misionit të Qeverisë, është harmonizuar, komunikon dhe zhvillohet tutje me objektivat e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të lartpërmendura, por edhe dokumenteve tjera strategjike e planifikuese që janë duke u hartuar siç është Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale. Kjo për të siguruar se reforma në fushën e drejtësisë është e plotë dhe gjithëpërfshirëse. Sigurisht që hartimi i PZHS-së është zhvilluar në atë mënyrë që mbi të gjitha mundëson arritjen e objektivave të konsideruara deri tani në draft Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030.

2. Metodologjia

Hartimi i PZHS-së ka kaluar në disa faza. Së pari janë mbledhur të dhënat dhe informatat nga dokumentet planifikuese të përmendura në Kapitullin 1 si dhe raporte tjera të ndryshme qoftë të organizatave dhe projekteve ndërkombëtare por edhe atyre të brendshme për funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë. Këto kanë shërbyer si bazë për identifikimin e problemeve, objektivave dhe zhvillimin e aktiviteteve specifike. Mirëpo të njëjtat do të ishin të pamjaftueshme pa mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe informatave praktike përbrenda MD-së që është bërë në fazën e dytë të zhvillimit të PZHS-së.

Në kuadër të fazës së dytë, anëtarët e grupit punues për hartimin e PZHS-së, të mbështetur nga projektet zhvillimore në kuadër të MD-së, kanë takuar përfaqësuesit e çdo agjencie ekzekutive, departamenti dhe njësite tjera në kuadër të MD-së për të diskutuar të dhënat dhe informatat e lartpërmendura me qëllim të konkretizimit të tyre të mëtutjeshëm dhe identifikimit të saktë të problemeve, por edhe zgjidhjeve për to.

Faza e tretë ka përfshirë hartimin e draftit të parë të PZHS-së nga anëtarët e grupit punues. Marr parasysh qartësinë dhe efikasitetin në hartim, është bërë një ndërlidhje konkrete në mes të sfondit, objektivave dhe aktiviteteve specifike të PZHS-së. Me

⁹ Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026. Janar 2022. E qasshme në: <https://md.rks.gov.net/desk/inc/media/FE2B3346-A26C-449E-A903-A8290C138A0B.pdf>

zhvillimin e këtij drafti të parë, në fazën e katërt Plani është ndarë me Sekretarin e Përgjithshëm të MD-së, departamentet dhe agjencitë e lartpërmendura për komentet dhe pikëpamjet e tyre specifike. Plani është ndarë edhe me Ministren si udhëheqëse e institucionit dhe kabinetin e saj për sigurimin e adresimit të qëllimeve politike të Programit të Qeverisë në PZHS. Krejt në fund i njëjti është vendosur në platformë të konsultimit publik të Qeverisë, për të siguruar mundësinë e përfshirjes së institucioneve tjera me interes, organizatave jo-qeveritare por edhe publikut të gjerë, në PZHS.

Pas kalimit të katër fazave, PZHS është miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Për të qenë i suksesshëm ky Plan, natyrisht që duhet të monitorohet në mënyrë efikase. Në këtë drejtim, çdo agjenci ekzekutive, departament dhe njësi do të raportojë çdo gjashtë (6) muaj mbi zbatimin e aktiviteteve specifike në kompetencë të tyre. Këto raporte do të dërgohen në DIEKP, që pastaj harton raportin gjithëpërfshirës gjashtë (6) mujor për zbatimin e PZHS-së tek Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministria e Drejtësisë për vlerësim të mëtutjeshëm dhe miratim. Rregullat, udhëzimet dhe shabllonet për këtë raportim përcaktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i MD-së.

Në anën tjetër, veprimet specifike të PZHS-së do të rishikohen çdo fund të vitit (2023 dhe 2024), ndërsa në fund të vitit 2025 planifikohet të bëhet një vlerësim i tërësishëm i PZHS-së ku do të vlerësohet edhe arritja e Objektivave të përcaktuara në Kapitullin 4.

3. Sfondi

Në Kapitullin 1 të këtij Plani janë elaboruar kompetencat e MD-së. Aty gjithashtu përmendet fakti se pavarësisht zhvillimeve, mbesin një sërë problemesh dhe sfidash të cilat pengojnë MD-në që të funksionojë në mënyrë efikase në zbatimin e kompetencave dhe ashtu siç kërkohet në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE dhe me pritjet e publikut të gjerë.

Për qëllime të PZHS-së, këto sfida dhe probleme kanë të bëjnë kryesisht me politika dhe ligje pjesërisht të zbatuara, pastaj mungesë të kapaciteteve profesionale në MD, sistem i vjetërsuar i punës, pengesa në zbatimin e plotë të kompetencave nga agjencitë ekzekutive në kuadër të MD-së, dhe nevoja për qasje më të madhe të publikut në punët e MD-së.

Fillimisht, nga dokumentet strategjike të përmendura në Kapitullin 1 por edhe raportet e ndryshme evidentohet nevoja për rritjen e efikasitetit të administrimit të drejtësisë. Kjo nënkupton ngritjen e cilësisë së politikave dhe ligjeve, veçanërisht legjislacionit primar, që zhvillohet nga Ministria e Drejtësisë. Ekziston nevoja sidomos që të rritet cilësia përmes dy metodave: 1) së pari duke fuqizuar sistemin *ex-ante* të politikëbërjes dhe ligjëbërjes që nënkupton zhvillimin e tyre dhe marrjen e vendimeve nga Ministria duke u

bazuar në të dhëna, dhe 2) së dyti duke fuqizuar sistemin *ex-post*, gjegjësisht të monitorimit të zbatimit, ashtu që vendim-marrësit të njoftohen për sfidat dhe problemet e zbatimit të politikave dhe ligjeve në mënyrë të strukturuar dhe bazuar në dëshmi. Kur flitet për të dhënat është kyçe që ato të ndahen edhe sipas gjinisë për të vlerësuar ndikimin në barazi gjinore.

Një pjesë kyçe sa i përket zhvillimit të legjislacionit është edhe përafrimi me legjislacionin e BE-së, për të cilin Ministria e Drejtësisë ka nevojë të ketë qasje proaktive, precize, të bazuar në hulumtim të *acquis* apo standardeve tjera evropiane dhe ndërkombëtare, gjatë hartimit të ligjeve relevante dhe zbatimit të tyre. Thënë këtë edhe koordinimi i procesit të anëtarësimit por edhe pjesës së mbështetjes së donatorëve për reformat, veçanërisht me institucionet tjera të sistemit të drejtësisë, duhet të përmirësohet tutje.




Figura 2: Cikli i zhvillimit të politikave nga MD

Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026 ka shpërfaqur veçanërisht problemin e kapaciteteve të limituara të Ministrisë së Drejtësisë për politikëbërjen bazuar në të dhëna dhe avancimin në procesin e integritit evropian në përgjithësi. Një ekip i zyrtarëve të specializuar të gatshëm për këtë proces është i nevojshëm. Kjo theksohet edhe në Raportin e BE-së për Kosovën ku përmendet nevoja për të përmirësuar planifikimin strategjik që kërkon më shumë përpjekje për të krijuar sisteme të besueshme statistikore në sistemin e drejtësisë.¹⁰ Rëndësia e statistikave, raportimit dhe komunikimit të duhur do të jetë edhe më e madhe me avancimin e Kosovës në procesin e anëtarësimit në BE.

¹⁰ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021. Faqe 21.

Kur flitet për kompetencat ekzekutive të MD-së ekziston nevoja që ato të shtohen në fusha të caktuara. Këtu mund të merret shembulli i mbikëqyrjes së profesioneve të lira, në të cilat MD ka aktualisht kompetenca të limituara sipas legjislacionit, por edhe kapacitete, që pengojnë mbikëqyrjen adekuate në praktikë.

Natyrisht që për arritjen e progresit në të gjitha fushat janë të nevojshme kapacitetet profesionale. Pavarësisht përgatitjes së avancuar profesionale dhe përvojës së gjatë së një pjese të stafit të MD-së, dhe marrë parasysh faktin që Rregullorja e brendshme e MD-së aktualisht nuk përkon me nevojat praktike, MD duhet të ketë një politikë edhe më konkrete dhe më afatgjatë të burimeve njerëzore që siguron 1) avancim të mëtutjeshëm profesional të të gjithë stafit ekzistues; 2) profilizim dhe efikasitet sa më të madh të mundshëm, duke bërë shpërndarje adekuate të detyrave të punës dhe eliminuar mbivendosjet përmes njësive të reja; 3) plotësim të pozitave vakante në këto njësi dhe njësitë tjera përmes rekrutimit meritore dhe 4) bartje adekuate të njohurive dhe shkathtësive tek stafi i ri që rekrutohet në MD, për të siguruar kështu memorie institucionale.

Njësia	Burra	Gra	Total
Kabineti i Ministres	8	7	15
Divizioni për Auditim	3		3
Divizioni për KPMJMFAPPGJDHS	2	3	5
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	21	18	39
Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira	2	1	3
Departamenti Ligjor	3	8	11
Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave	1	3	4
Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar	6	4	10
Departamenti për Profesione të Lira	2	3	5
Departamenti për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit	6		6
SHKK	1340	266	1606
SHSK	27	36	63
Avokatura Shtetërore	3	8	11
Inspektorati i Ministrisë	6	1	7
AAPSK	17	7	24
IML	38	19	57
ANJF	20	14	34
Totali	1506	398	1904

Figura 3 - Numri i të punësuarve aktualisht në MD dhe agjencitë ekzekutive në kuadër të MD-së

Edhe pse numri i burrave dhe grave të punësuar në MD, përveç SHKK-së, është pothuajse i barabartë, nevojiten masa shtesë për të rritur numrin e grave në pozita udhëheqëse të njësive në kuadër të MD-së dhe agjencive ekzekutive, me fokus të veçantë pikërisht në SHKK. Gjithashtu, duhet të arrihet numri i kërkuar ligjor për personat me aftësi të kufizuara të punësuar në MD dhe agjencitë ekzekutive të saj (1 në 50).

Shërbimet e brendshme dhe mbështetëse të MD-së duhet të avancohen tutje. Aktualisht, burimet njerëzore janë të shpërndara në mes të Ministrisë dhe agjencive ekzekutive duke krijuar kështu dallime të mëdha në volumin e punëve dhe koordinim më të vështirë. Grumbullimi i këtyre shërbimeve në një vend, për shembull IT, menaxhim të burimeve njerëzore, buxheti dhe financat, prokurimi, auditimi i brendshëm, logjistika, transporti, etj do të siguronte kompaktësi dhe efikasitet më të madh. Sidoqoftë, agjencitë ekzekutive me numër të madh të të punësuarve si SHKK duhet të kenë shërbimet e tyre të brendshme në kuadër të agjencisë.

Rëndësi e veçantë gjithashtu duhet t'i kushtohet planifikimit dhe mbikëqyrjes adekuate të kontratave me operatorët ekonomik, ashtu që mallrat dhe shërbimet e ofruara për nevojat e MD-së të jenë edhe më cilësore. Po ashtu, planifikimi buxhetor ka nevojë të përmirësohet, por edhe vlerësimi i ndikimit buxhetor të politikave dhe ligjeve dhe raportimi lidhur me buxhetin duhet të jenë sa më cilësor. Njësia e burimeve njerëzore duhet të marrë përsipër rolin në planifikimin e trajnimeve si dhe për stafin e ri të MD-së është i nevojshëm një program induksioni.

Sigurisht që faktori njeri është kyç për institucionin, por në efikasitetin e punës së stafit ndikojnë edhe mjetet e punës. Marrë parasysh zhvillimin e digjitalizimit dhe përshtypjet e konfirmuara përmes të dhënave janë se digjitalizimi në punën e MD-së është ende në fazat fillestare.

Aktualisht, nuk ka mjete të IT-së të dizajnuara për të lehtësuar vendim-marrjen në MD, si dhe janë rreth dhjetë baza të të dhënave të njësive të ndryshme në kuadër të MD-së që shërbejnë për mbështetje të procedurave administrative, por që kanë nevojë për përmirësime dhe ndërlydhje, përfshirë edhe me institucionet tjera.

Është e nevojshme pra, që avancimi në aspektin e digjitalizimit të zhvillohet në tre drejtime 1) digjitalizimi i shërbimeve që ofrohen nga MD; 2) ndërlydhja e bazave të ndryshme të të dhënave – aktualisht rreth dhjetë (10) të tilla; dhe 3) krijimi i bazave të reja të të dhënave apo aplikacioneve; të gjitha këto në shërbim të efikasitetit në punë por edhe qasjes më të lehtë të publikut në MD, pjesë e cila do të elaborohet më poshtë.

Vlen gjithashtu të theksohet, se për sa i përket aspekteve organizative dhe teknike të përpjekjeve për digjitalizim, stafi i IT-së, pajisjet, buxheti dhe investimet nuk janë të unifikuara, të planifikuara, të menaxhuara dhe të kontrolluara në një vend, por janë të

shpërndara në mes të departamenteve dhe agjencive ekzekutive të MD-së, ngjashëm edhe me shërbimet tjera.

Ofrimi i shërbimeve dhe informatave në mënyrë efikase tek palët e interesuara dhe publiku i gjerë është prioritet tjetër kyç për MD-në. MD duhet të jetë më afër publikut duke ofruar informata qoftë për shërbimet e brendshme që ndërlidhen me ofrimin e ndihmës juridike falas, pastaj certifikimin, licensimin dhe mbikëqyrjen e profesioneve të lira. Gjithashtu duke ofruar informata për: organizimin e provimit të jurisprudencës, kompensimin e viktimave të krimit dhe të tjera, apo edhe ato për sistemin e drejtësisë në përgjithësi, që referojnë tek procedurat e zhvilluara nga institucionet tjera të ndërlidhura me procedurat gjyqësore, siç janë për shembull të drejtat e palëve në këto procedura, mbrojtja e viktimave dhe të tjera. Qasja në regjistrat publik të MD-së dhe dokumentet publike në përgjithësi të zhvilluara dhe mbajtura nga MD është gjithashtu e rëndësishme thelbësore.

Përveç ofrimit të dokumenteve dhe informatave, promovimi i politikave të MD-së dhe mundësive për qytetarët, veçanërisht në tema për shembull si zgjidhja alternative e kontesteve, duhet të forcohet tutje në bashkëpunim me institucionet tjera të sistemit të drejtësisë. Publiku pra duhet të jetë sa më i familjarizuar me këto mundësi. Sigurisht që webfaqet e Ministrisë dhe agjencive tjera ekzekutive duhet të avancohen dhe përditësohen në këtë drejtim. Por natyrisht për të gjitha këto, MD ka nevojë të ketë një qasje strategjike të organizimit të burimeve njerëzore, kapaciteteve buxhetore dhe koordinimit të mbështetjes nga partnerët ndërkombëtarë.

Tërë këto sfida të paraqitura më lartë ndërlidhen edhe me funksionimin e agjencive ekzekutive në kuadër të MD-së. Sa i përket ekzekutimit të sanksioneve penale, ekziston një momentum me miratimin e Ligjit të ri në këtë fushë, si dhe ligjeve të veçanta për SHKK-në dhe SHSK-në. Për të zbatuar këto ligje në mënyrë adekuate, të dy organizatat duhet të zhvillojnë planifikimin e tyre strategjik të zhvillimit institucional, që adreson së pari bashkëpunimin në mes tyre, shpërndarjen adekuate të stafit, pastaj transparencën, bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, koordinimin me donatorët dhe të tjera. Inspektorati për mbikëqyrjen e punës së institucioneve korrektuese dhe drejtorive rajonale sprovuese gjithashtu duhet të avancoj planifikimin dhe kapacitetet për të zbatuar ligjet e lartpërmendura në mënyrë efikase.

Sa i përket AAPSK-së ekzistojnë kufizime në realizimin adekuat të mandatit që nënkupton përdorimin e pasurive të paluajtshme të konfiskuara për interes publik. Për këtë, Ministria është në proces të ndryshimit të legjislacionit relevant që ndër të tjera ka synim të themelot Fondin e Konfiskimit. Përveç kësaj, synohet të rishikohen aktet relevante nënligjore dhe procedurat standarde të veprimit. Baza e të dhënave e AAPSK-së ka nevojë të avancohet dhe ndërlidhet me bazat tjera të të dhënave të institucioneve të drejtësisë. Sigurisht që për të menaxhuar Fondin e lartpërmendur në mënyrë adekuate

dhe zbatuar mandatin plotësisht, AAPSK duhet të ketë strategji të brendshme që ngrit nivelin e zhvillimit strategjik të institucionit.

Edhe IML duhet të rishikoj strategjinë e brendshme duke analizuar dhe adresuar sfidat me kornizën ligjore, kushtet e sigurisë në punë si dhe mundësoj akreditimin e proceseve të punës. Rishikimi i strategjisë së brendshme duhet të bëhet edhe nga ANJF ashtu që të reflektohen ndryshimet e fundit institucionale dhe të arrihet synimi i shtrirjes së ndihmës juridike falas në tërë territorin e Kosovës dhe tek grupet e cenushme.

Përfundimisht, është identifikuar edhe nevoja për rritjen e numrit të avokatëve shtetëror për të menaxhuar volumin e madh të rasteve që Avokatura Shtetërore e ka në rolin e përfaqësimit të institucioneve publike. Veçanërisht në fushën e arbitrazhit, duhet të ngritën kapacitetet qoftë të avokatëve ekzistues shtetëror, por edhe në kuptim të specializimit të avokatëve të rinj që rekrutohen.

4. Objektivat

Në programin qeverisës dhe PSO 2021 - 2025 të MD-së, në përputhje me mandatin dhe misionin e saj, MD kishte përcaktuar 5 qëllime kryesore strategjike (objektiva kryesore), të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e integritetit të institucioneve të drejtësisë dhe reformimin penal e civil, adresimin e krimeve të luftës, dhunës në familje dhe ndaj grave si dhe digjitalizimin e shërbimeve në drejtësi.

Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë përmes vetingut dhe mekanizmave të tjerë

Me qëllim të përmirësimit të integritetit të institucioneve të drejtësisë dhe për ta rritur besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, MD ka paraparë si qëllim të parë strategjik "Përmirësimin e integritetit të institucioneve të drejtësisë përmes vetingut dhe mekanizmave të tjerë". Një sërë veprimesh janë ndërmarrë për ta realizuar objektiven e tillë dhe në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, MD do të angazhohet dhe do të kontribuojë në kompletimin e kornizës së nevojshme ligjore në mënyrë që të realizohet procesi i vetingut.

Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative

Përmes hartimit dhe ndryshimit të politikave në fushën e drejtësisë penale, civile dhe administrative, synohet reformimi i drejtësisë penale, civile dhe administrative.

Adresimi i krimeve të kryera në Kosovë dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare

Për të adresuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, MD ka paraparë zhvillimin e politikave të cilat ndër të tjera, do të ndikojnë në

rritjen e kapaciteteve profesionale të Prokurorisë Speciale, pastaj ka paraparë krijimin e Institutit për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, si dhe zhvillimin e politikave për drejtësi tranzicionale, në të cilat përfshihet edhe korniza ligjore për personat e zhdukur.

Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira ligjore dhe digjitalizimi i sistemit të drejtësisë

Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira ligjore si qëllim tjetër strategjik, do të bëhet nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe njerëzore për profesionet e lira. Pas evidentimit të nevojës për digjitalizim në sistemin e drejtësisë, janë ndërmarrë veprime dhe do të vazhdohet me veprimet konkrete me qëllim të digjitalizimit që ndër tjerash, ka synim ofrimin e shërbimeve efikase ndaj qytetarëve.

Parandalimi dhe adresimi i dhunës në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore

Në kuadër të objektivës së pestë, përveç veprimeve konkrete të deritanishme, Ministria e Drejtësisë do të angazhohet në zhvillimin e politikave dhe funksionalizimin e mekanizmave kundër dhunës, si dhe sensibilizimin e publikut në parandalimin e saj.

Në harmonizim me qëllimet e tilla strategjike dhe gjithashtu duke u bazuar në problemet dhe sfidat e identifikuara në Kapitullin 3 të këtij Plani, janë krijuar katër objektiva të brendshme të MD-së. Gjithashtu, këto janë në përputhje me misionin e Qeverisë dhe bazohen në metodologjinë SMART, pra janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të caktuara në kohë. Tabela në vijim paraqet katër objektivat e Ministrisë që synohen të arrihen deri në vitin 2025.



Ministria e përgatitur me staf profesional



Digjitalizimi i MD-së



Agjenci ekzekutive efikase në kuadër të MD-së



Ministria më afër publikut

Figura 4 - Objektivat e brendshme të MD-së

4.1. Objektivi 1 - Ministria e përgatitur me staf profesional

Ristrukturimi i MD-së, i përcjellur me plotësimin e të gjitha pozitive vakante, profilizimi dhe numri i trajnimeve të veçanta për stafin e MD-së, do të jenë treguesit për arritjen e Objektivit 1, mirëpo natyrisht ngritja e kapaciteteve të stafit të MD-së mund të vlerësohet edhe nga progresi që arrihet në objektivat tjerë. Veçanërisht faktor matës këtu është edhe arritja e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara këtu, në Planin e Punës të Qeverisë dhe programet tjera të ndërlidhura, që reflektojnë edhe në dy Strategjitë kryesore të Ministrisë, ajo për Sundimin e Ligjit dhe ajo për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave.

Qëllimi i ristrukturimit të MD-së është ndarja praktike dhe adekuate e shërbimeve në departamente dhe divizione, ashtu që secili departament dhe divizion të rrisë performancën.

4.2. Objektivi 2 - Digjitalizimi i MD-së

Sa i përket Objektivit 2, do të vlerësohet rritja e numrit të shërbimeve të digjitalizuara që aktualisht është zero, pastaj numri i bazave të të dhënave të ndërlidhura, si dhe numri i bazave të reja të të dhënave dhe aplikacioneve të krijuara nga tash e deri në 2025. Sigurisht që kjo gjatë vlerësimit përfundimtar të PZHS-së do të përcjellët edhe me një vlerësim për funksionimin adekuat të këtyre shërbimeve dhe bazave të të dhënave.

4.3. Objektivi 3 - Agjenci ekzekutive efikase në kuadër të MD-së

Meqë pothuajse të gjitha agjencitë ekzekutive në kuadër të MD-së do të zhvillojnë ose rishikojnë strategjitë e tyre të brendshme, matja e arritjes së Objektivit 3 do të bëhet nga të dhënat që ofrohen nga ato strategji. Sa i përket Avokaturës Shtetërore, synimi është që numri i kontesteve të fituara të ngritet për 25% deri në vitin 2025.

4.4. Objektivi 4 - Ministria më afër publikut

Kompletimi dhe përditësimi efikas i webfaqeve të MD-së dhe agjencive ekzekutive me të dhënat relevante si dhe ofrimi i qasjes në dokumente publike në përputhje me afatet ligjore, do të jenë treguesit për arritjen e Objektivit 4. Përveç kësaj, në vitin e parë të zbatimit të PZHS-së do të zhvillohet një sondazh me publikun për të matur njohurinë me politikën e zhvilluar nga MD dhe kënaqshmërinë me shërbimet e ofruara. Të dhënat pastaj do të krahasohen me një sondazh tjetër që do të zhvillohet gjatë vlerësimit përfundimtar të PZHS-së.

5. Ndikimi Buxhetor

Për zbatimin efektiv të 182 veprimeve nga Plani Zhvillimor Strategjik 2023-2025, kërkohet nga departamentet e MD-së si dhe agjencitë e përfshira në zbatim të sigurojnë burime të mjaftueshme (njerëzore dhe financiare) në afatet e parapara sipas strategjisë. Më tej, zbatimi i suksesshëm i veprimeve të tilla kërkon angazhim proaktiv nga të gjitha institucionet e involvuara në zbatimin e PZHS, në veçanti nga strukturat menaxhuese të institucioneve përkatëse si dhe kabineti politik i Ministrisë së Drejtësisë.

Duke u bazuar në *Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e ndikimit të buxhetit për nismat e reja të Qeverisë si dhe Manualin e tij*, është bërë kostimi i të gjitha veprimeve specifike të propozuara. Metodologjia e punës gjatë përlllogaritjes së ndikimit buxhetor të përafërtë është bazuar në burime përkatëse të çmimeve referente, me modifikime të ndryshme për të pasqyruar specifikat e veprimeve të propozuara. Përveç kësaj, analiza e kostos është bazuar në të dhënat historike buxhetore, sidomos në veprimet që gjenden edhe në Strategjinë e Sundimit të Ligjit 2021-2026 si dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026, informatat dhe trendet e zbatimit, dhe poashtu është bazuar në planifikimet për të ardhmen, duke përdorur supozimet adekuate për të arritur në vlerësimin e kostos së veprimeve specifike.

Vlen të theksohet se PZHS është plan i veprimit i cili përmbanë një sërë veprimesh të planifikuara për zbatim edhe në dy dokumente fundamentale të sektorit të sundimit të ligjit: SSL dhe SMDHFDHG. Rrjedhimisht, vlerësimi i ndikimit buxhetor është paraqitur në terma bruto, që nënkupton që të gjitha veprimet në PZHS janë krahasuar dhe sinkronizuar një nga një me çdo veprim nga këto dokumente strategjike, ashtu që të vlerësohet saktësisht kostoja bruto dhe neto e PZHS. Konkretisht, nga vlera e përgjithshme e ndikimit buxhetor të PZHS-së, që është rreth **2,642,658 EUR**, brenda për brenda kësaj shume të përgjithshme veprimet të cilat përmbahen edhe në SSL peshojnë rreth **1,154,810 EUR**, ndërsa veprimet të cilat përmbahen edhe në SMDHFDHG peshojnë diku rreth **188,430 EUR**. Prandaj, vlera neto e kostos shtesë vetëm nga PZHS si dhe e ndryshme nga strategjitë tjera të sektorit të sundimit të ligjit është rreth **1,299,418 EUR**.




Figura 5 – Shpërndarja në përqindje e kostos së veprimeve të PZHS në kategori të: veprimeve të reja në kuadër të PZHS, veprimeve ekzistuese nga SSL dhe veprimeve ekzistuese nga SMDHFDHG

Tutje, për të kuptuar më rrënjësisht përbërjen e ndikimit buxhetor, atëherë përmes të dhënave të mëposhtme faktike të kostimit të PZHS-së sipas objektivave, kuptojmë që:

- Kostoja e përgjithshme e katër objektivave të PZHS është **2,642,657.65 EUR**
 - Kostoja e përgjithshme për objektivin 1 (Ministria e përgatitur me staf profesional) është **1,572,036.84 EUR**
 - Kostoja e përgjithshme për objektivin 2 (Digjitalizimi i MD-së) është **163,239.78 EUR**
 - Kostoja e përgjithshme për objektivin 3 (Agjenci ekzekutive efikase në kuadër të MD-së) është **401,583.30 EUR**
 - Kostoja e përgjithshme për objektivin 4 (Ministria më afër publikut) është **505,797.73 EUR**

Në vazhdim, tabela më poshtë prezanton të dhënat mbi vlerësimin e kostos, për katër objektivat e PZHS të shpërndara përgjatë tre viteve si dhe nën-totalet e tyre respektive.

Tabela 1: Përmbledhje e kostos (ndikimit buxhetor)

OBJEKTIVAT	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	TOTAL
I: MINISTERIA E PËRGATITUR ME STAF PROFESIONAL	€ 758,130	€ 374,216	€ 439,691	€ 1,572,037
II: DIGJITALIZIMI I MD-SË	€ 106,682	€ 26,365	€ 30,192	€ 163,240
III: AGJENCI EKZEKUTIVE EFIKASE NË KUADËR TË MD-SË	€ 142,241	€ 129,671	€ 129,671	€ 401,583
IV: MINISTERIA MË AFËR PUBLIKUT	€ 137,121	€ 204,438	€ 164,238	€ 505,798
TOTAL PËR OBJEKTIVAT:	€ 1,144,174	€ 734,691	€ 763,793	€ 2,642,658

Vlerësimi i ndikimit buxhetor nga tabelat 1 është paraqitur në terma bruto, për periudhën trevjeçare 2023-2025, duke sugjeruar që potencialisht, një pjesë e kostove mbulohet me burimet ekzistuese buxhetore të qeverisë dhe potencialisht edhe burimet financiare nga jashtë. Konkretisht, në bazë të përlogaritjeve nga kjo analizë, nga kostoja e përgjithshme e PZHS, prej 2,642,658, pjesa më e madhe parashihet të alokohet nga Buxheti në shumën prej rreth 1,499,304 EUR, ndërsa pjesa e mbetur parashihet të mbulohet nga burime të jashtme, në shumën prej 1,143,554 EUR, duke përfshirë këtu përkrahjen nga donatorët e ndryshëm dhe partnerët zhvillimor.



Figura 6 – Burimet e financimit të PZHS-së

Duke analizuar nga perspektiva e klasifikimit buxhetor, respektivisht nga këndvështrimi i kategorive ekonomike, implikimet e kostos së veprimeve që rrjedhin nga objektivat e PZHS, ato mund të përmbledhen në kategorinë e 'pagave dhe mëditjeve' dhe 'mallra dhe shërbime', dhe të dyja këto dy kategori bien nën 'shpenzime korrente'. Tabela në vijim jep informacion më të detajuar mbi koston treguese, sipas kategorive të buxhetit ekonomik.

Tabela 2: Përmbledhje e shpërndarjes së kostos sipas kategorive ekonomike për të gjitha objektivat e PZHS

Kategoritë buxhetore ekonomike	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	TOTAL
Paga dhe mëditje	€ 825,582	€ 437,308	€ 516,230	€ 1,779,120
Mallra dhe shërbime	€ 318,592	€ 297,383	€ 247,563	€ 863,538
Shpenzime komunali	-	-	-	-
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-	-
TOTAL	€ 1,144,174	€ 734,691	€ 763,793	€ 2,642,658

Rrjedhimisht, ne mund të konkludojmë me të dhënat e mëposhtme faktike të kostos:

- Sipas përlllogaritjeve të kostos gjithëpërfshirëse të PZHS, kostoja e përgjithshme për vitin 2023 e PZHS vlerësohet të jetë rreth **1,144,174 EUR**
- Sipas përlllogaritjeve të kostos gjithëpërfshirëse të PZHS, kostoja e përgjithshme për vitin 2024 e PZHS vlerësohet të jetë rreth **734,691 EUR**
- Sipas përlllogaritjeve të kostos gjithëpërfshirëse të PZHS, kostoja e përgjithshme për vitin 2025 e PZHS vlerësohet të jetë rreth **763,793 EUR**
- Pjesa dërmuese e kostos së përgjithshme nën kategorinë buxhetore 'paga dhe mëditje' brenda për brenda PZHS është saktësisht rreth **1,779,120 EUR**
- Kostoja e përgjithshme nën kategorinë buxhetore 'mallra dhe shërbime' brenda për brenda PZHS është saktësisht rreth **863,538 EUR**.

6. Veprimet specifike

Me qëllim të zbatimit të objektivave të elaboruara më sipër janë hartuar veprime specifike që mundësojnë realizimin e këtij Plani në praktikë. Këto veprime specifike do të kontribuojnë drejtpërdrejtë edhe në zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në dokumentet tjera strategjike në përgjegjësi të MD-së të nivelit qeveritar apo edhe ndër-institucional.

Këto veprime specifike të planifikuara për vitet 2023-2025 janë gjithëpërfshirëse dhe përmbajnë aktivitete që i'u adresohen të gjitha departamenteve, divizioneve dhe agjencive ekzekutive të Ministrisë.

Sa i përket objektivit të parë "Ministria e përgatitur me staf profesional", veprimet specifike janë të fokusuara në ristrukturimin e Ministrisë me qëllim të rritjes së efikasitetit, forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve ekzistuese të stafit me trajnime specifike në fushat që janë identifikuar si të nevojshme (si për shembull përfarimi ligjor, vlerësimi ex-post, etj).



Figura 7 - Disa nga llojet e veprimeve specifike në kuadër të Objektivit 1

Objektivi i dytë "Digjitalizimi i MD-së" ka derivuar si përgjigje ndaj nevojave dhe kërkesave të kohës për digjitalizim. Për këtë qëllim, veprimet specifike të këtij objektivi përfshijnë krijimin, funksionalizimin, ndërlihdjen, avancimin e bazave të ndryshme të të dhënave dhe aplikacioneve në kuadër të njësive të ndryshme në Ministri dhe agjenci ekzekutive të Ministrisë, pastaj qasjen e MD-së në SMIL dhe SEQP për qëllime të zbatimit të kompetencave të Ministrisë, krijimin e platformave online për shërbimet që ofrohen nga Ministria e Drejtësisë siç janë provimi i jurisprudencës dhe provimet për profesionet e lira, dhe të tjera.



Figura 8 - Disa nga llojet e veprimeve specifike në kuadër të Objektivit 2

Tek objektivi i tretë “Agjenci ekzekutive efikase në kuadër të MD-së” është synuar të fuqizohen agjencitë ekzekutive përmes aktiviteteve kryesore që ndërlidhen me hartimin dhe rishikimin e planeve strategjike nga agjencitë dhe hartimin e Rregulloreve për organizimin e brendshëm të tyre.




Figura 9 - Disa nga llojet e veprimeve specifike në kuadër të Objektivit 3

Objektivi i katërt “Ministria më afër publikut” përmban aktivitete që në qendër kanë rritjen e transparencës së punës së Ministrisë dhe komunikimin me publikun përmes ridizajnit të webfaqes së Ministrisë, hapjes së llogarive sociale të Ministrisë për përfshirje më të gjerë, lansimin e fushatave të ndryshme të ndërgjegjësimit dhe takimet e bashkëbisedimet e rregullta me qytetarë.



Figura 10 - Disa nga llojet e veprimeve specifike në kuadër të Objektivit 4

Të gjitha veprimet specifike të Planit Zhvillimor Strategjik të MD-së janë të listuara në Shtojcën 1 e cila është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

SHTOJCA 1 - VEPRIMET SPECIFIKE TË PLANIT ZHVILLIMOR STRATEGJIK TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Numri	Veprimi	Afati i fundit			Buxheti	Buxheti	Buxheti	Buxheti	Buxheti	Burimi i financimit	Njësia përfjegjëse	Rezultati	Referenca në dokumente
		2023	2024	2025									
OBJEKTIVI 1 - MINISTRIA E PËRGATITUR ME STAF PROFESIONAL													
